



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
KOMISIONI PËR SIGURINË KOMBËTARE**

Tiranë më 15.04.2019
(Dokument parlamentar)

**RAPORT
PËR**

AKTIN NORMATIV NR. 1, DATË 20.03.2019 “PËR PJESËMARRJEN E PERSONELIT TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË MISIONIN E KOMBEVE TË BASHKUARA NË SUDANIN E JUGUT (UNMISS)”

- ***Hyrje***

Komisioni për Sigurinë Kombëtare, bazuar në nenet 32-36 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e datës 15.04.2019, mori në shqyrtim projektaktin normativ nr. 1, datë 20.03.2019 “Për pjesëmarrjen e personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në Misionin e Kombeve të Bashkuara në Sudanin e Jugut (UNMISS)”

Për shqyrtimin e këtij projektakti normativ u caktua relator deputeti Xhemal Qefalia.

Për të bërë prezantimin e projektaktit normativ në komision mori pjesë Zëvendësministri i Mbrojtjes z.Petro Koçi si dhe përfaqësues të tjerë nga Minisitria e Mbrojtjes.

- ***Vlerësimi i Ligjshmërisë Kushtetuese dhe harmonizimi me legjislacionin në fuqi dhe aktet ndërkombëtare.***

Projektakti normativ është në harmoni me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me ligjin nr.9363, datë 24.3.2005, “Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe ligjit nr.64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

- **Qëllimi, përmbajtja dhe risitë e projektaktit normativ**

Ky projektakt normativ ka për qëllim pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, me 2 (dy) ushtarakë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, në Misionin e Kombeve të Bashkuara në Sudanin e Jugut (UNMISS), në Republikën e Sudanit të Jugut.

Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (UNSCR) 1996, datë 8 korrik 2011, autorizoi Misionin e Kombeve të Bashkuara në Sudanin e Jugut (UNMISS) për një periudhë fillestare prej një viti, nga data 9 korrik 2011, me të drejtë për vazhdimësi në periudha të mëtejshme.

UNMISS ka objektiv konsolidimin e paqes dhe të sigurisë, si dhe ndihmën në krijimin e kushteve për zhvillim në Republikën e Sudanit të Jugut, me qëllim forcimin e kapacitetit të qeverisë së Sudanit Jugor për të qeverisur në mënyrë efektive dhe demokratike e për të krijuar marrëdhënie të mira me fqinjët e saj.

Për statusin e Forcave, më 8.8.2011, në Juba, është nënshkruar Marrëveshja e Statusit të Forcave (SOFA), ndërmjet Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) dhe Qeverisë së Republikës së Sudanit të Jugut (*The status of forces agreement between the United Nations and the government of the Republic of South Sudan concerning the United Nations mission in South Sudan*).

Në bazë të deklaramit zyrtar, Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, duke filluar nga viti 2019, propozohet të marrin pjesë për 12 (dymbëdhjetë) muaj, me 2 (dy) ushtarakë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, në Misionin e Kombeve të Bashkuara në Sudanin e Jugut (UNMISS), në Republikën e Sudanit të Jugut, me të drejtë për vazhdimësi në periudha të mëtejshme.

Detyrat kryesore që do të kryejë personeli ushtarak janë, si më poshtë vijon:

- të marrë pjesë në analizën e zbulimit gjithëburimësh lidhur me rreziqet dhe aktivitetin e përgjithshëm të zbulimit, duke u fokusuar në aftësitë ushtarake dhe mundësitë që u ofron terreni grupeve ndërluftuese;
- të ketë njohje të situatës për zonën e operacioneve të FRR-së dhe për gjithë vendin në përgjithësi;
- të japin kontributin e tyre në përgatitjen e informacionit për gjeohapësirën, situatën politike, grupet e armatosura, grupet etnike, migracionin sezonal, refugjatët, fushat e minuara dhe sulmet me mjete shpërthyes të improvizuara, si dhe indikacione të tjera në zonën e operacionit;
- të kryejnë mbledhje informacioni në përputhje me kërkesat prioritare për informacion dhe Planin e Mbledhjes së Informacionit;
- të përgatisë plane dhe kërkesa për vëzhgim/vrojtim dhe aktivitete të tjera ushtarake për mbledhjen e informacionit;
- të bëjë menaxhimin e kërkesave për informacion, me qëllim plotësimin e mangësive në informacion sipas kërkesave;

- të shtojnë informacion dhe vlerësim aktual në situatën e përgjithshme ushtarake të procesit të vendimmarrjes për FRR-në.
- të përditësojnë *database*-in e informacioneve të zbulimit dhe të japin kontribut në përditësimin e *database*-it të shtabit të FRR-së;
- të jenë pika kyçe në koordinimin dhe ndërmjetësimin midis vendeve kontribuese me trupa, oficerëve koordinatorë ushtarakë, shtabit të FRR-së, operacioneve ajrore, policisë së OKB-së dhe organizatave qeveritare dhe joqeveritare;
- të përgatisin vlerësime rreziku;
- të zhvillojnë stërvitje familjarizuese me trupat e mbërritura rishtas në zonën e operacionit, të prezantojnë për delegacione dhe vizitorë në qoftë se kërkohet.

Efektet financiare për periudhën 12 (dymbëdhjetë) muaj, do të përballohen nga OKB-ja.

Në bazë të angazhimeve të Forcave të Armatosura në kuadër të OKB-së, personeli i përzgjedhur është dërguar në trajnim paraprak në Juba, të Republikës së Sudanit të Jugut, në datë 6.4.2019.

• **Përfundime**

Komisioni për Sigurinë Kombëtare, pasi e shqyrtoi projektaktin në parim, nen për nen dhe në tërësi, me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm në mbledhje e miratoi atë duke vlerësuar se:

Në aspektin ligjor, projektakti i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.

Në aspektin procedural, projektakti është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

RELATOR

KRYETARE

XHEMAL QEFALIA

ERMONELA VALIKAJ (FELAJ)